

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nënit 109 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092

Për: **KUVENDI KOMUNAL I PRIZRENIT**

Për Aktivitetin e Prokurimit: **622-26-4204-2-1-1**

Sa i përket tenderit për: **Sigurimi Fizik i objekteve të KPSH-së**

A N K E S Ë

1. Identifikimi i Ankuesit

SKYFTERAT-LIVE SH.P.K.

(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

RR.REXHEP BISLIMI 1

(Adresa)

FERIZAJ

(Vendi)

70 000

(Kodi postar)

048 100 800

(Numri Telefonit)

NUK APLIKOHET

(Numri i Faks-it)

NJAZI SYLA

(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

skyfterat-live@hotmail.com

(Adresa elektronike)

24.08.2026

(Data e parashtrimit të ankesës)

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

(Emri i avokatit)

(Adresa e plotë)

(Numri i Telefonit)

(Numri i faks-it)

(Adresa elektronike)

(Data e parashtrimit të ankesës)

(Nënshkrimi dhe vula)

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar “Njoftimi për Kontratë” apo “Njoftimi për konkurs të projektimit” dhe, nëse aplikohet “Njoftimi për dhënie të Kontratës”, “Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit”, nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

Autoriteti Kontraktues: Kuvendi Komunal i Prizrenit

Lënda: Shërbime

Procedura e prokurimit: Procedurë e hapur

FPP fjalori kryesor: 93000000-8 Shërbime të ndryshme

Vlera e parashikuar: 680,000.00€ (e madhe)

B05 Njoftimi për Kontratë: Data: 03.06.2026

Afati për dorëzimin e tenderëve: Data: 21.08.2026

Njoftimi i anulimit të aktivitetit të prokurimit: Data: 17.08.2026

Kriteri për dhënien e kontratës: Oferta e përgjegjshme me Çmimin më të ulët

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐

Jo ☒

Anulimi i aktivitetit të prokurimit është bërë në mënyrë elektronike përmes platformës së E-prokurimit, sipas Njoftimit B10.

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po ☐

Jo ☒

Anulimi i aktivitetit të prokurimit është bërë në mënyrë elektronike përmes platformës së E-prokurimit, sipas Njoftimit B10.

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkesë për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po ☒

Jo ☐

Konform dispozitës Neni 108/A të LPP-së në afatin e lejuar ligjor kemi paraqitur kërkesën për rishqyrtim konkretisht me datën 19.08.2026 nëpërmjet platformës së E-prokurimit, kurse AK-ja as nuk e ka pezulluar aktivitetin e prokurimit e as nuk na ka kthyer ndonjë përgjigje apo vendim në lidhje me kërkesën e paraqitur.

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

1. Ligji për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës Nr. 04/L-042 i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092.

Neni 1 - Qëllimi,
Neni 7 - Barazia në trajtim / Jo-diskriminimi,
Neni 9 - Përcaktimi i nevojave që duhet përmbushur,
Neni 62 - Përfundimi i Aktivitetit të Prokurimit.

2. Rregullore Nr.001/2022 për Prokurimin Publik

Neni 43 - Ndërprerja e procedurave të prokurimit.

3. Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbarimore (Konsoliduar)

Udhëzimi Administrativ Nr. 08/2009 për Ekzekutimin dhe Pagesën e Vendimeve Përmbaruese të Gjykatave

4. Ligji Nr. 03/L-048 për Menaxhimin E Financave Publike dhe Përgjegjësitë

PJESA VII Zotimet, fondet e alokuara, fondet e zotuara, fondet e obliguara dhe shpenzimet

5. Rregull Financiare Nr.01/2013/MF – Shpenzimi i Parave Publike

Neni 12 – Zotimi i fondeve

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të kërkesës suaj për rishqyrtim.

Në mbështetje të nenit 109 të Ligjit Nr.04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar, SKYFTERAT-LIVE SH.P.K., në cilësinë e palës së interesuar konform nenit 4.1.26 të LPP-së, paraqet këtë **Ankesë**, duke kundërshtuar në tërësi vendimin e Autoritetit Kontraktues për anulimin e aktivitetit të prokurimit nr. 622-26-4204-2-1-1.

ANKESË

KRONOLOGJIA:

Duke **kundërshtuar në tërësi anulimin e aktivitetit të prokurimit**, për shkak se konsiderojmë se arsyeja e përdorur për anulim nuk është demonstruar në përputhje me kërkesat e legjislacionit të prokurimit publik dhe nuk përmbush kushtet ligjore për ndërprerjen e procedurës para hapjes së ofertave.

Me datën 17.08.2026 është publikuar Formulari B10 – Njoftimi për anulimin e aktivitetit të prokurimit, nga ana e Autoritetit Kontraktues (Kuvendi Komunal i Prizrenit).

Për tu publikuar ky njoftim Autoriteti Kontraktues ka vepruar në kundërshtim me dispozitat ligjore të LPP-së dhe Rregullores Nr.001/2022, duke **anashkaluar procedurat** tjera para se të bëjë publikimin e këtij Njoftimi B10.

Sipas nenit 21.4 pika (f) të Rregullores Nr.001/2022 thuhet: Autoriteti Kontraktues duhet të publikoj Njoftimin mbi Vendimin e AK (B58) edhe në rast se vendimi ka të bëjë me anulimin e aktivitetit të prokurimit në tërësi ose një/disë Lot e në kuadër të aktivitetit të prokurimit.

Poashtu sipas nenit 43.1 të Rregullores Nr.001/2022 thuhet: Në rast të vendimit të anulimit të procedurës së prokurimit, AK menjëherë do të përgatisë dhe do të publikoj Formularin B58 “Njoftimin mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues” ku paraqiten arsyet faktike dhe bazën ligjore të anulimit të tillë.

Gjithashtu tek neni 43.2 i Rregullores Nr.001/2022 thuhet: Pas skadimit të afatit kohor për parashtrim dhe shqyrtim të ankesave, do të përgatitet-publikohet Njoftimi për Anulim të aktivitetit të prokurimit dhe njoftimin e tillë do ta publikojë në platformën e prokurimit elektronik.

Pra në platformën e e-Prokurimit tek aktiviteti i prokurimit me të dhënat: **Sigurimi Fizik i objekteve të KPSH-së** me nr.prokurimit: **622-26-4204-2-1-1**, shihet qartazi se **nuk ekziston asnjë publikim** i njoftimit mbi vendimin e AK-së.

Provë:

Imazhi i nxjerrur nga aktiviteti i prokurimit në platformën e E-prokurimit.

Emërtimi	Sigurimi Fizik i objekteve të KPSH-së
Kodi intern i procedurës	622-26-4204-2-1-1
Autoriteti kontraktues	KUVENDI KOMUNAL I PRIZRENIT
Lënda	2 Shërbime
Procedura e prokurimit	1 Procedurë e hapur
FPP fjalori kryesor	93000000-8 Shërbime të ndryshme
Statusi	
Statusi i pezullimit të tenderit	Kërkesa për rishqyrtim është paraqitur



Duke e parë parasysh se Autoriteti Kontraktues ka vepruar në kundërshtim me dispozitat ligjore, ne kemi vepruar sipas rregullave dhe dispozitave ligjore të Prokurimit Publik.

Kompania jonë ka vepruar konform **nenit 60.1 pika (c) të Rregullores Nr.001/2022**

thuhet: Kurdo qe kërkesa për rishqyrtim ka të bëjë me vendimin e AK për anulimin e procedurës së prokurimit, brenda afatit prej pesë (5) ditëve pas datës së publikimit të njoftimit mbi vendimin e AK (B58) për anulim të procedurës së prokurimit në sistem të prokurimit elektronik. Në kalkulim të afateve kohore, dita e publikimit të Njoftimit mbi vendimit të AK është dita (0).

Meqenëse nuk kemi pasur Njoftim mbi vendimin e AK (B58) por kemi pasur direkt anulim pa i përfillur procedurat tjera, pra kemi vetëm Njoftimin B10 për anulimin e aktivitetit të prokurimit, i cili është publikuar me datën 17.08.2026, atëher kompania jonë:

Me datën 19.08.2026 nëpërmjet platformës së e-Prokurimit kemi dorëzuar kërkesën për rishqyrtim pranë Autoritetit Kontraktues (Kuvendi Komunal i Prizrenit).

Pas dorëzimit të kërkesës për rishqyrtim nga ana jonë, Autoriteti Kontraktues përsëri nuk ka rrespektuar dispozitat ligjore **neni 61.1 të Rregullores Nr.001/2022 thuhet:**

Parashtrimi i kërkesës për rishqyrtim **automatikisht pezullon procedurën e prokurimit** dhe në këtë rast Autoriteti Kontraktues, respektivisht Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit, duhet të njoftoj me shkrim të gjitha palët lidhur me pezullimin e procedurës së prokurimit në fjalë.

Pasi që nuk ishte pezulluar procedura e prokurimit përkundër se kemi paraqitur kërkesën për rishqyrtim, ne kemi pritur që Autoriteti Kontraktues të nxjerr një vendim në lidhje me kërkesën tonë të dorëzuar, qoftë refuzim apo miratim të saj.

Sipas nenit 63.2 të Rregullores Nr.001/2022 thuhet: Vendimi mbi refuzimin ose miratimin është obligativ dhe do të publikohet në sistem të prokurimit elektronik si “Dokument shtesë” tek dosja e tenderit nga Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit.

Në rastet kur zyrtari Përgjegjës i Prokurimit nuk nxjerrë vendim në lidhje me kërkesën për shqyrtim dhe nuk njofton operatorin ekonomik për afat shtesë, **Operatori Ekonomik ka të drejte qe të parashtroj një ankese pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit** pas skadimit të afatit prej 3 (tre) dite pune nga data e dorëzimit të kërkesës për rishqyrtim. Në kalkulim të afateve kohore data e dorëzimit të kërkesës për rishqyrtim është dita (0).

Andaj meqenëse nuk kemi pranuar asnjë përgjigje nga ana e Autoritetit Kontraktues (Kuvendi Komunal i Prizrenit) as edhe një vendim refuzim/miratim e as ndonjë kërkesë shtesë për zgjatjen e afatit shtesë, atëher jemi obliguar që të veprojmë në përputhje me dispozitat ligjore sipas Nenit 109 të LPP-së dhe Nenit 64.1 të Rregullores Nr.001/2022.

Konsiderojmë se anulimi është bërë pa u demonstruar ekzistimi i kushteve ligjore që lejojnë ndërprerjen e aktivitetit para hapjes së ofertave, ndërsa arsyetimi i paraqitur nga AK nuk përmbush standardin e kërkuar nga **neni 43.1 dhe neni 43.8(a) i Rregullores Nr.001/2022 për Prokurimin Publik**.

Në veçanti, një deklaram i përgjithshëm se mjetet buxhetore janë marrë nga përmbaruesi nuk është i mjaftueshëm për të provuar se ka ndodhur një ngjarje objektive, e demonstrueshme, jashtë kontrollit të AK-së dhe e paparashikueshme në momentin e inicimit të procedurës.

I. VENDIMI DHE ARSYETIMI I KUNDËRSHTUAR

Në Njoftimin për Anulim AK ka përzgjedhur si arsye:

“Ndërprerja e aktivitetit të prokurimit është i nevojshëm për shkak të ngjarjeve dhe/apo arsyeve objektive dhe të demonstrueshme të cilat janë jashtë kontrollit të autoritetit kontraktues dhe të cilat kanë qenë të paparashikueshme në kohën e inicimit të aktivitetit të prokurimit.”

Ndërsa, në pjesën “Informacionet shtesë”, AK e arsyeton anulimin me:

“mungesën e mjeteve buxhetore në kategorinë e mallrave dhe shërbimeve si shkak i marrjes së mjeteve buxhetore nga ana e përmbaruesit”, duke iu referuar gjithashtu “trendit të marrjes së mjeteve buxhetore nga ana e përmbaruesit” dhe duke konkluduar se realizimi i projektit do të ishte i pamundur edhe për vitet në vijim.

Pikërisht ky arsyetim konsiderojmë se nuk përmbush kriteret ligjore për anulim.

Provë:

Arsyetimi i përdorur tek Njoftimi B10 – për anulimin e aktivitetit të prokurimit.

V.2) INFORMACIONET SHITESË

Shto informacione tjera:

Pershendetje te nderuar, Kerkoj nga ju qe te shqyrtoni mundesine e anulimit te procedures se prokurimit lidhur me projektin e Sigurimit fizik te objekteve te KPSH, duke pasur parasysh faktin e mungeses se mjeteve buxhetore ne kategorine e mallrave dhe sherbimeve si shkak i marrjes se mjeteve buxhetore nga ana e permbaruesit. Duke pasur parasysh vleren e parashikuar per realizim te ketij projekti dhe trendit te marrjes se mjeteve buxhetore nga ana e permbaruesit, konsiderojme qe realizimi i ketij projekti do te ishte ishte i pamundur per vitet ne vijim bazuar ne kapacitetet buxhetore qe ka drejtoria.

Dokumentet-Vendimet e Kryetarit të Komunës në lidhje me aktivitetin e prokurimit
“Sigurimi fizik i objekteve shëndetësore të KPSH-së”.

Vendimi i parë i lëshuar me datën 26.03.2026, i cili është anuluar më pastaj dhe është lëshuar **Vendimi i dytë** i datës 21.05.2026, pas ndryshimit të vlerës së parashikuar të kontratës nga 270,000.00 EUR në vlerën e re sipas vendimit të fundit në 680,000.00 EUR.



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Në bazë të nenit 13 dhe 58 pika b të Ligjit nr. 03/L-040, për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28/2008) dhe nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit nr. 01/011-5643, të datës 15.10.2008, pas kërkesës së Drejtorisë së Shëndetësisë, kryetari i Komunës, merr këtë:

VENDIM

1. Miratohet kërkesa e Drejtorisë së Shëndetësisë, për lejin e sigurimit fizik të objekteve të shëndetësisë primare të Komunës së Prizrenit, kështu që, për këtë qëllim lejohet shpallja e tenderit për mbledhjen e ofertave përkatëse.
2. Kontrata do të jetë trevjeçare (kontratë kornizë).
3. Ky projekt realizohet sipas kodit të planifikuar buxhetor të Drejtorisë së Shëndetësisë-mallra dhe shërbime.
4. Me këtë vendim anulohet Vendimi 01 nr. 147/26, i datës 26.03.2026.
5. Obligohet Drejtoria e Shëndetësisë, Sektori i Prokurimit dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave për zbatimin e këtij vendimi.
6. Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e nënshkrimit të tij.

- Vendimi iu dërgohet:
- Drejtorisë së Shëndetësisë,
 - Drejtorisë së Ekonomisë dhe Financave,
 - Sektorit të Prokurimit,
 - Arkivës së Kryetarit.

Kryetari i Komunës
Shaqir Totaj





Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Beledijesi

Në bazë të nenit 13 dhe 58 pika b të Ligjit nr. 03/L-040, për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28/2008) dhe nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit nr. 01/011-5643, të datës 15.10.2008, pas kërkesës së Drejtorisë së Shëndetësisë, kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M

1. Miratohet kërkesa e Drejtorisë së Shëndetësisë, për lejjimin e sigurimit fizik të objekteve të shëndetësisë primare të Komunës së Prizrenit, kështu që, për këtë qëllim lejohet shpallja e tenderit për mbledhjen e ofertave përkatëse.
2. Kontrata do të jetë trevjeçare (kontratë kornizë).
3. Ky projekt realizohet sipas kodit të planifikuar buxhetor të Drejtorisë së Shëndetësisë-mallra dhe shërbime.
4. Obligohet Drejtoria e Shëndetësisë, Sektori i Prokurimit dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave për zbatimin e këtij vendimi.
5. Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e nënshkrimit të tij.

Kryetari i Komunës
Shaqir Totaj



- Vendimi iu dërgohet:
- Drejtorisë së Shëndetësisë,
 - Drejtorisë së Ekonomisë dhe Financave,
 - Sektorit të Prokurimit,
 - Arkivës së Kryetarit.

II. SHKELJA E NENIT 9 TË LPP-SË – DISPONUESHMËRIA E FONDEVE PARA INICIMIT

Neni 9 i LPP-së vendos detyrime konkrete për Autoritetin Kontraktues para inicimit të një aktiviteti të prokurimit lidhur me vlerësimin e nevojave dhe disponueshmërinë e fondeve.

Aktiviteti konkret është iniciuar dhe Njoftimi për Kontratë është publikuar më **04.06.2026**.

Rrjedhimisht, AK para inicimit është dashur të kryejë procedurat e përcaktimit të nevojave dhe disponueshmërisë së fondeve dhe të ketë bazën përkatëse financiare për iniciimin e aktivitetit.

Ky fakt krijon një çështje themelore:

Nëse fondet kanë ekzistuar dhe janë konfirmuar në momentin e inicimit, AK duhet të dëshmojë se çfarë ngjarjeje konkrete ka ndodhur pas inicimit, në cilën datë, në çfarë shume dhe pse ajo ngjarje nuk ka mundur të parashikohej më 04.06.2026.

Pa këtë demonstrim, anulimi nuk mund të mbështetet vetëm në një deklaram të përgjithshëm për mungesë fondesh.

Në vijim kemi bashkangjitur dëshmitë “Deklaratën e Nevojave dhe Përcaktimit të Disponueshmërisë së Fondeve” e miratuar me datën 25.05.2026 e nënshkruar nga personat e autorizuar ZKF dhe e konfirmuar nga ZKA (Kryetari i Komunës) me datën 26.05.2026.

Provë:

Dokumentet e bashkangjitura DNPDF e datës 25.05.2026.

Dëshmi shtesë lidhur me procedurën në fjalë.

025

Deklarata e Nevojave dhe Përcaktimit të Disponueshmërisë së fondeve

Sipas Nenit 9 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Data

25.05.2026

E rezervuar për AQP

Data e pranimit

Identifikuesi

Nr. i Prokurimit:

NENI I: IDENTIFIKIMI I AUTORITETIT KONTRAKTUES (AK)

Emri i AK	Komuna e Prizrenit	Personi kontaktues	Alban Susuri
		e-mail	alban.susuri@rks-gov.net
Adresa	Rruga RemziAdemajpn.	Kodi postar	20 000
Qyteti	Prizren	Regjioni	Prizren
Telefoni	038 20044704	Faksi	
e-mail	prokurimipz@hotmail.com	URL:	

NENI II: LËNDA E KONTRATËS

II.1. VLERËSIMI I NEVOJAVE

II.1.1 Klasifikimi (FPP):

II.1.2 Natyra dhe fushëveprimi:

[Përshkruaj natyrën e saktë dhe fushëveprimin e nevojave specifike]

Sigurimi fizik për objektet e KPSH

Kodi i projektit: 00000

II.1.3 Vlera e parashikuar:

680,000.00€

II.1.4 Kushtet Materiale:

Lënda e kësaj kontrate është:

Sigurimi Fizik për Objektet e Kujdesit Parësor Shëndetësor

II.1.5 Specifikacionet funksionale, përfitimet dhe kostot:

Referoju Aneksit I të bashkangjitur.

II.1.6 Planifikimi:

A ka qenë ky aktivitet i prokurimit i përfshirë në parashikimin e prokurimit?

Po

☒


Jo

☐

Nëse jo, deklaro arsyen pse nuk ka qenë i përfshirë

II.1.7 Deklarata lidhur me atë se si ky prokurim do të promovojë objektivat institucionale të autoriteteve kontraktuese:

[deklarata]

Departamenti kërkues:	Drejtoria e Shendetesise
Zyrtari kërkues:	Sylejman Baxhaku
Data:	25.05.2026
Nënshkrimi i personit kërkues	

II.2 DISPONUSHMËRIA E FONDEVE

II.2.1 Deklarata mbi disponueshmërinë e fondeve:

Zyrtari Kryesor Financiar "ZKF" duhet formalisht të sigurojë që fondet janë të disponueshme për prokurimin në fjalë.

[në rast të një autoriteti publik apo një organizate buxhetore]


Zyrtari Kryesor Financiar "ZKF" duhet formalisht të sigurojë që janë përvetësuar mjetet për prokurimin në fjalë në një shumë të mjaftueshme për të përmbushur obligimet financiare që mund të rrjedhin gjatë periudhës së vitit të tanishëm fiskal si rezultat i këtij prokurimi.

A është ky projekt shumë-vjeqar?

Po ☒


Jo ☐

II.2.2 Deklarata e mos-disponueshmërisë nga ndonjë autoritet tjetër publik (nëse AK është një Autoritet publik apo një organizate buxhetore):

Zyrtari Kryesor Financiar:	Lulzim Sylejmani
Nënshkrimi i Zyrtarit Kryesor Financiar:	
Data e aprovimit nga ZKF:	25.05.2026

II.2.3 Aprovimi:

Për aktivitetin e prokurimit në fjalë të shfaqur në këtë formularë, Zyrtari Kryesor Administrativ njofton se kërkesat e nenit 9.1-9.4 të LPP-së janë në përmbushur nga Autoriteti Kontraktues dhe jep pajtimin e tij/saj për iniciimin e aktivitetit të prokurimit.

Zyrtari Kryesor Administrativ:	Shaqir Totaj
Nënshkrimi i Zyrtarit Kryesor Administrativ:	
Data e aprovimit nga ZKA:	26.05.26

III. RREGULLA FINANCIARE NR.01/2013/MF – ZOTIMI I FONDEVE PARA PROKURIMIT

Rregulla Financiare Nr.01/2013/MF për Shpenzimin e Parave Publike është veçanërisht relevante.

Sipas nenit 4, procesi i shpenzimit të parave publike përmban elementet:

ndarja buxhetore – alokimi – zotimi – prokurimi – obligimi – pagesa.

Neni 7 përcakton se ndarjet buxhetore regjistrohen në SIMFK dhe sistemi përmban kontrole të brendshme që shpenzimet të mos realizohen nëse nuk ekzistojnë fonde të mjaftueshme.

Edhe më i rëndësishëm është **neni 12.**

Sipas nenit 12.1:

“Zotimi është njohje kontabël në SIMFK” e një shpenzimi të mundshëm të ardhshëm të parave publike.

Ndërsa neni 12.2, duke iu referuar nenit 36.1 të LMFPP-së, kërkon që **para inicimit të procesit të prokurimit**, organizata buxhetore t'i regjistrojë zotimet e fondeve të ndara në SIMFK.

Rregulla Financiare gjithashtu përcakton se moduli i blerjeve në SIMFK përdoret për regjistrimin e zotimeve dhe obligimeve për shpenzimet që kërkojnë prokurim dhe se zotimi njihet kur procedohet kërkesa për blerje.

Kjo e bën të domosdoshme që AK të paraqesë gjendjen reale të SIMFK-së, jo vetëm një deklaram të përgjithshme për mungesë mjetes.

IV. NENI 43.8(a) – KUSHTET PËR ANULIM PARA HAPJES SË OFERTAVE

Neni 43.8(a) i Rregullores Nr.001/2022 përcakton se procedura para hapjes së ofertave mund të anulohet:

për shkak të ngjarjeve të demonstrueshme dhe/ose arsyeve jashtë kontrollit të AK-së, të cilat nuk kanë qenë të parashikueshme në kohën e fillimit të procedurës së prokurimit.

Gjithashtu, anulimi sipas kësaj dispozite duhet të bëhet së paku tre ditë para hapjes së tenderëve.

Pra, dispozita vendos disa kushte që duhet të provohen në rastin konkret:

1. duhet të ekzistojë një ngjarje/arsye konkrete;
2. ajo duhet të jetë e demonstrueshme;
3. duhet të jetë jashtë kontrollit të AK-së;
4. nuk duhet të ketë qenë e parashikueshme në kohën e fillimit të procedurës;
5. duhet të ekzistojë lidhja konkrete ndërmjet kësaj ngjarjeje dhe nevojës për anulimin e procedurës.

Në Njoftimin për Anulim nuk është demonstruar plotësimi i këtyre kushteve.

V. “TRENDI I PËRMBARIMEVE” KUNDËRSHTON PRETENDIMIN PËR PAPARASHIKUESHMËRI

Vetë AK deklaron se ekziston një:

“trend i marrjes së mjeteve buxhetore nga ana e përmbaruesit”.

Ky formulim është në kundërthënie serioze me bazën e zgjedhur për anulim.

Nëse kemi të bëjmë me një **trend**, atëherë bëhet fjalë për një dukuri që nuk paraqitet për herë të parë në mënyrë krejtësisht të papritur.

Prandaj AK duhet të dëshmojë:

- kur ka filluar ky “trend”;
- cilat përbarime kanë ekzistuar para 04.06.2026;
- kur është njoftuar Komuna për detyrimin konkret;
- kur ka marrë formë të prerë titulli përbarimor;
- kur është iniciuar procedura përbarimore;
- dhe kur janë marrë konkretisht mjetet.

Nëse AK ka qenë në dijeni për detyrimin ose për rrezikun real të ekzekutimit para inicimit të aktivitetit, atëherë kushti i **paparashikueshmërisë** nuk mund të konsiderohet automatikisht i përmbushur.

VI. LMFPP – PËRMBARIMI NUK E KRIJON AUTOMATIKISHT DETYRIMIN PËR ANULIM

Ligji Nr.03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë përmban dispozita të posaçme për ekzekutimin e vendimeve të formës së prerë kundër autoriteteve publike.

Neni 40 përcakton mekanizmin përmes të cilit realizohen këto pagesa.

Fakti që ekziston një detyrim përbarimor nuk do të thotë automatikisht se çdo aktivitet tjetër i prokurimit i organizatës buxhetore duhet të anulohet.

Duhet të demonstrohet se përbarimi konkret ka prekur realisht fondet e aktivitetit dhe se pas këtij ekzekutimi nuk ekziston një mundësi ligjore dhe financiare për vazhdimin e aktivitetit.

Në veçanti duhet të shqyrtohen mekanizmat e paraparë nga neni 40 i LMFP-së për rastet kur ndarjet buxhetore në dispozicion nuk janë të mjaftueshme për ekzekutimin e menjëhershëm të tërë detyrimit.

Rrjedhimisht:

përmbarimi dhe anulimi i tenderit janë dy çështje juridike të ndryshme.

Ligjshmëria e përmbarimit nuk e prodhon automatikisht ligjshmërinë e anulimit.

VII. UDHËZIMI ADMINISTRATIV NR.08/2009 DHE LIGJI PËR PROCEDURËN PËRMBARIMORE

Edhe Udhëzimi Administrativ Nr.08/2009 për Ekzekutimin dhe Pagesën e Vendimeve Përmbaruese të Gjykatave dhe Ligji Nr.04/L-139 për Procedurën Përmbarimore duhet të interpretohen në harmoni me LMFP-në.

Këto dispozita rregullojnë **mënyrën e realizimit të detyrimeve përmbarimore.**

Ato nuk krijojnë vetvetiu një bazë të re për anulimin e aktiviteteve të prokurimit publik.

Për anulim AK vazhdon të jetë i detyruar t'i plotësojë kushtet specifike të LPP-së dhe nenit 43 të Rregullores Nr.001/2022.

Prandaj AK duhet të identifikojë:

- titullin konkret përmbarimor;
- numrin e lëndës;
- kreditorin;
- shumën;
- datën e ekzekutimit;
- mënyrën e ekzekutimit;
- ndarjen buxhetore të prekur;
- dhe ndikimin konkret në zotimin e aktivitetit nr. 622-26-4204-2-1-1.

VIII. SHKELJA E NENIT 43.1 – MUNGESA E ARSYETIMIT FAKTIK DHE BAZËS LIGJORE

Ky është një nga pretendimet kryesore të kësaj Ankese.

Neni 43.1 i Rregullores Nr.001/2022 përcakton se në rast të vendimit për anulimin e procedurës së prokurimit, AK duhet menjëherë të përgatisë dhe publikojë Formularin:

B58 – “Njoftimi mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues”

ku duhet të paraqiten:

arsyet faktike dhe baza ligjore e anulimit.

Kjo dispozitë nuk është vetëm kërkesë formale.

Qëllimi i saj është që pala e interesuar të mund ta kuptojë saktësisht:

Çfarë ka ndodhur?

Kur ka ndodhur?

Cili fakt e ka shkaktuar anulimin?

Cila provë e vërteton atë fakt?

Dhe mbi cilën dispozitë ligjore konkrete mbështetet anulimi?

Në rastin konkret, një deklaram i përgjithshëm se:

“përmbaruesi ka marrë mjetet”

nuk e zëvendëson demonstrimin faktik që kërkon neni 43.1, e aq më pak provon kushtet materiale të nenit 43.8(a).

Njoftimi për Anulim nuk identifikon së paku:

- shumën e mjeteve të marra;
- datën e marrjes së tyre;
- titullin përmbarimor;
- numrin e lëndës përmbarimore;
- datën kur AK ka marrë dijeni për detyrimin;
- kodin buxhetor nga i cili janë ekzekutuar;
- shumën që ka ekzistuar para përmbarimit;
- shumën e mbetur pas përmbarimit;
- zotimin konkret të këtij aktiviteti;
- ndikimin konkret të përmbarimit në këtë zotim;
- analizën financiare që demonstroi pamundësinë e vazhdimit;
- bazën juridike që lidh përmbarimin konkret me domosdoshmërinë e anulimit të aktivitetit.

Përkundrazi, në B10 është dhënë vetëm një konstatim i përgjithshëm për mungesën e mjeteve në kategorinë mallra dhe shërbime dhe “trendin” e përmbarimeve.

Kjo nuk është e njëjtë me **paraqitjen e arsyeve faktike dhe bazës ligjore**, siç kërkon shprehimisht neni 43.1.

Për këtë arsye konsiderojmë se vendimi është i mangët edhe në aspektin e arsyetimit dhe transparencës së vendimmarrjes.

IX. DUHET TË VERIFIKOHET RESPEKTIMI I PROCEDURËS B58 → B10

Përveç përmbajtjes së vendimit, duhet të verifikohet edhe procedura që AK ka ndjekur për anulimin.

Sipas nenit 43.1, në rast të vendimit për anulim, AK duhet **menjëherë** të përgatisë dhe publikojë Formularin **B58 – Njoftimi mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues**, ku paraqiten arsyet faktike dhe baza ligjore e anulimit.

Ndërsa procedura e nenit 43 duhet të respektohet në tërësi para finalizimit të anulimit dhe publikimit të B10.

Dokumenti që kemi në dispozicion është:

B10 – Njoftimi për Anulimin e Aktivitetit të Prokurimit, i përgatitur më **14.08.2026**.

Për këtë arsye kërkojmë që AK të verifikojë dhe të dëshmojë:

1. datën e marrjes së vendimit për anulim;
2. datën e publikimit të B58;
3. përmbajtjen e plotë të B58;
4. arsyet faktike të paraqitura në B58;
5. bazën ligjore të paraqitur në B58;
6. respektimin e afatit për ushtrimin e mjeteve juridike;
7. datën e përgatitjes dhe publikimit të B10;
8. respektimin e rendit procedural të kërkuar nga neni 43.

Nëse **B58 nuk është publikuar**, ose nëse B58 nuk përmban arsyet faktike dhe bazën ligjore të kërkuar nga neni 43.1, atëherë kemi një mangësi procedurale që duhet të shqyrtohet veçmas nga vetë arsyeja materiale e anulimit.

X. AK DUHET TË DËSHMOJË NËSE JANË PREKUR FONDET E KËTIJ AKTIVITETI

Njoftimi për Anulim nuk deklaron se përmbaruesi ka marrë pikërisht fondet e zotuar për aktivitetin nr. 622-26-4204-2-1-1.

Ai thotë vetëm se ekziston mungesë e mjeteve në:

“kategorinë e mallrave dhe shërbimeve”.

Ky dallim është thelbësor.

Zvogëlimi i përgjithshëm i një kategorie buxhetore nuk provon automatikisht pamundësinë e financimit të këtij aktiviteti specifik.

AK duhet të dëshmojë lidhjen:

fondet e aktivitetit → zotimi në SIMFK → përmbarimi → zvogëlimi/anulimi i zotimit → pamundësia reale e financimit.

Pa këtë lidhje dokumentare nuk mund të konsiderohet e provuar domosdoshmëria e anulimit.

XI. PRETENDIMI PËR PAMUNDËSI “PËR VITET NË VIJIM” ËSHTË I PADEMONSTRUAR

AK deklaron se:

“realizimi i këtij projekti do të ishte i pamundur për vitet në vijim bazuar në kapacitetet buxhetore që ka drejtoria.”

Ky është një konkluzion për të ardhmen.

Por në Njoftimin për Anulim nuk është paraqitur:

- analizë financiare shumëvjeçare;
- projeksion i buxhetit;
- ndarje buxhetore për vitet përkatëse;
- detyrime të pritshme përmbarimore;
- plan i rrjedhës së parasë;
- apo dokument tjetër që demonstroi këtë pamundësi.

Termi **“konsiderojmë”** nuk e zëvendëson standardin **“të demonstrueshme”** të nenit 43.8(a).

XII. EKZISTENCA E MEKANIZMAVE PËR MENAXHIMIN E FONDEVE

Rregulla Financiare Nr.01/2013/MF parashikon mekanizma për menaxhimin e ndarjeve dhe alokimeve.

Neni 8 njeh mundësinë e transferimit të ndarjeve buxhetore ndërmjet programeve dhe kodeve ekonomike sipas rregullave të LMFPP-së.

Neni 10 gjithashtu rregullon alokimin e fondeve dhe parashikon që, nëse organizata buxhetore dëshiron ndryshimin e alokimeve për t'iu përshtatur ndryshimeve në planin e ekzekutimit të buxhetit, kërkesa i drejtohet Drejtorit të Thesarit.

Prandaj, para se mungesa momentale e fondeve të përdoret si bazë për anulim, duhet të demonstrohet situata konkrete financiare dhe pamundësia reale e vazhdimit në kuadër të mekanizmave ligjorë në dispozicion.

XIII. PARIMET E LPP-SË

Vendimmarrja e AK-së duhet të jetë në përputhje jo vetëm me dispozitën teknike për anulim, por edhe me parimet themelore të LPP-së lidhur me:

- ekonomikitetin dhe efikasitetin;
- transparencën;
- trajtimin e barabartë;
- integritetin e procedurës;
- dhe përdorimin e ligjshëm të fondeve publike.

Anulimi është një veprim me pasoja të drejtpërdrejta për konkurrencën dhe operatorët ekonomikë që kanë investuar kohë dhe resurse në përgatitjen për procedurën.

Prandaj arsyeja e anulimit duhet të jetë reale, konkrete, e provueshme dhe juridikisht e mbështetur.

XIV. KONKLuzion

Nga interpretimi i përbashkët i:

- Ligjit Nr.04/L-042 për Prokurimin Publik;
- nenit 9 të LPP-së;
- nenit 62 të LPP-së;
- nenit 108/A të LPP-së;
- nenit 43.1 të Rregullores Nr.001/2022;
- nenit 43.2 të Rregullores;
- nenit 43.8(a) të Rregullores;
- Ligjit Nr.03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë;
- dispozitave të LMFPP-së mbi zotimet dhe ekzekutimin e vendimeve gjyqësore;
- Ligjit Nr.04/L-139 për Procedurën Përmbaremore;
- Udhëzimit Administrativ Nr.08/2009 për Ekzekutimin dhe Pagesën e Vendimeve Përmbareuese të Gjykatave;
- Rregullës Financiare Nr.01/2013/MF – Shpenzimi i Parave Publike;
- dhe rregullave për SIMFK, alokimin dhe zotimin e fondeve,

konsiderojmë se **arsyetimi i paraqitur nga AK nuk demonstroi plotësimin e kushteve ligjore për anulimin e aktivitetit të prokurimit.**

Në veçanti, AK:

- **nuk ka demonstruar ngjarjen konkrete të paparashikueshme;**
- **nuk ka demonstruar shumën dhe datën e përmbarimit;**
- **nuk ka demonstruar se janë prekur pikërisht fondet e këtij aktiviteti;**
- **nuk ka demonstruar gjendjen e zotimit në SIMFK;**
- **nuk ka demonstruar pamundësinë e financimit të aktivitetit;**
- **nuk ka demonstruar pamundësinë e realizimit për vitet e ardhshme;**

dhe arsyetimi i publikuar nuk paraqet në mënyrë të plotë faktet dhe bazën juridike që kërkon **neni 43.1 i Rregullores Nr.001/2022 për Prokurimin Publik.**

Për më tepër, referimi nga vetë AK në një **“trend” të përmbarimeve** krijon dyshim serioz nëse rrethana e përdorur për anulim mund të konsiderohet njëkohësisht e **paparashikueshme** në kuptimin e nenit 43.8(a).

Për këto arsye konsiderojmë se anulimi, **mbi bazën dhe arsyetimin konkret të paraqitur nga AK, nuk është juridikisht i qëndrueshëm dhe duhet të anulohet.**

XV. KËRKESA

Duke u bazuar në sa më sipër, kërkojmë nga Paneli Shqyrtues i OSHP-së:

- 1. TË APROVOJË** si të bazuar këtë Ankesë;
- 2. TË ANULOJË** vendimin/njoftimin për anulimin e aktivitetit të prokurimit nr. 622-26-4204-2-1-1;
- 3. TË VAZHDOJË** aktivitetin e prokurimit nga faza në të cilën është ndërprerë;

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar ka shkaktuar ose kërcënohet t'iu shkaktojë dëme materiale, në rast se përfshini pretendime për kompensim.

Neve si palë e interesit në këtë aktivitet të prokurimit na janë krijuar shpenzime të konsiderueshme në përgatitjen e dokumentacionit (ofertës) dhe pjesëve të tjera të cilat ndërlidhen me këtë aktivitet të prokurimit si: shpenzimet për përgatitjen e ankesave si në fazën e parë dhe atë të dytë, përfaqësimeve të cilat mund të ndodhin etj.

Dëmi reflekton në dëmin material dhe jo-material duke mos u kufizuar edhe në dëmin e imazhit dhe pasojave të tjera që në këtë fazë nuk janë në tërësi të konkretizuara.

10. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

- a) një kopje të publikimit të “Njoftimit për Kontratë” apo “Njoftimit për Konkurs të Projektimit.
- b) një kopje të publikimit për “Njoftimin e Dhënies së Kontratës” apo “Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimit për Anulim”.
- c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.
- d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet.